



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E OBILIQI OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1-128
Br.

Data 30.09.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga DSHPE nr.VI-825, të dt.28.09.2020, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

1. Bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit nr.I-67, të dt.25.04.2019 i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale me anëtarin Hamit Mjeku në vend të Ibush Mjekiqit.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të cekur më lartë bëhet për arsye se anëtari i deritanishëm nuk mund të jetë pjesë e këtij Komisioni në mungesë të kohës, i cili mban edhe postin e Nënkrjetarit të Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'idërgohet

- Kryetarit
- Nënkrjetarit
- Kryesuesit
- MPL-së
- DSHPE-së
- Anëtarëve të Komisionit
- Anëtarëve të KK-së
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri




nr. VI-825 / 28.09.2020



Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Data	28.09.2020
Për	Kryesuesin e Kuvendit Komunal z. Burim Gërguri
Nga	Naim Miftari Drejtor i DSHPE-së
Lënda	Kërkesë për plotësim dhe ndryshim të vendimit



I nderuar!

Kërkojm nga ana e juaj që seancën e cila është planifikuar të mbahet me dt. 29.09.2020 të plotësoni dhe ndryshoni vendimin me nr.-I-67 i dt.25.04.2019,për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale. Anëtari i këtij komisioni z. Ibush Mjekiqi të zëvendësohet me z. Hamit Mjeku, për arsye se anëtari i deritanishëm nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni në munges të kohës i cili mban edhe pozitën e Nënkrjetarit të komunës.

Me respekt!

Numri i aktit:

Nr. 1-67
Dt.

Data 25.04.2019
Datimi



PROJEKTI (33/14)


Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, bazuarë në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr 07/96 ,dt.02.04.2019 , pika 3 e vendimit , Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.18.4.2019, mori këtë:

V E N D I M


1. Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale.
2. Komisioni sipas pikës (1) të këtij vendimi përbëhet prej pesë (5) anëtar
 - 2.1.Naim Miftari ,Drejtor i DSHPE-së ,Kryesues i Komisionit
 - 2.2.Ibush Mjekiqi, Nënkryetar Komune dhe u.d.DSHMS, anëtar
 - 2.3.Fatmir Bekteshi, anëtar i Kuvendit, anëtar
 - 2.4.Labinot Mirena, anëtar i Kuvendit , anëtar
 - 2.5.Eljesa Terbunja, kryetar i shoqatës së HENDIKOS ,anëtar
3. Në komision , pjesëmarrës do të jetë edhe një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit nga shoqëria civile .
4. E drejta në banim për përfituesit nga kjo kategori bëhet në Kompleksin kolektiv banesor afarist " HADE dhe HADE 2 " për banorët e Komunës së Obiliqit
5. Në kompleksin kolektiv , pesdhjetë (50 %) të njësisve banesore destinohet për qëllim të zgjedhjes së banimit për kategoritë për familjet që janë raste sociale.
6. Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale vendosë në bazë të procedurave të parapara me Ligjin Nr/03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim, Udhëzimit Administrativ Nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.24/2010 për normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit të nxjerra në bazë të këtij ligji.



7. Komisioni në takimin e pare do të vendos për metodologjinë e punës për të gjithë procesin e përzgjedhjes për përfituesit e të drejtës në banim .
8. Komisioni, vlerësimin e gjendjes në banimit në teren , të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të kërkueseve e hënë në afat prej fridhjetë (30) ditësh .
9. Pas vlerësimit të gjendjes së banimit nga tereni i familjeve nga ana e Komisionit , Komuna publikon listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fitura gjatë vlerësimit .
10. Mandati i komisionit zgjat deri në dhënien në shfrytëzim të njësiye banesore për përfituesit të së drejtës në banim sipas pikës (5) të këtij vendimi.
11. Komisioni për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit Komunal
12. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL
- Anëtarëve të Komisionit
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri

